

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A do të mbyllet konstituimi i Kuvendit më 9 shtator?
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/a-do-te-mbyllet-konstituimi-i-kuvendit-me-9-shtator-i513126
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:32:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 16:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9cd9d1b7883fa6ba84c73075f24961f045fc862883adbe5f65cd8371e97394ec
TEKSTI	c9a317c7183b70450d14bc4ca8ba90c621ec6638f52cea1eeea2bdf3ba8d75f0
PAMJA	170af27a93e75875c160e6bb3f71804239429e8cac58319376455d7fa0c292f1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4a5d2877550b90a0d3dd6c38b349448c7ef4cbc0d34a1d5be4b72952e449c033
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4a5d2877550b90a0d3dd6c38b349448c7ef4cbc0d34a1d5be4b72952e449c033>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

3 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

9 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

9 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

Aktualitet

A do të mbyllet konstituimi i Kuvendit më 9 shtator?

Kërkesë kjo që i ishte pranuar edhe në nisje të seancës konstituive më 6 gusht. Kurti atëherë kishte deklaruar se "konstituimi kësaj radhe nuk bën të jetë drejt një shpërndarjeje të Kuvendit dhe përsëri zgjedhjeve të parakohshme, të paarsyeshme e të panevojshme".



8 Shtator 2026, 18:21
Nga G.M



Kuvendi i Kosovës. Fotografi nga arkivi

Është bërë një muaj qëkurse seanca konstituive e Kuvendit u ndërpre më 8 gusht, pasi kreu i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Albin Kurti, njëherësh kryeministër në detyrë, nuk e propozoi një kandidat për kryetar por kërkoi kohë shtesë deri në arritjen e një marrëveshjeje politike për presidentin.

Kërkesë kjo që i ishte pranuar edhe në nisje të seancës konstituive më 6 gusht. Kurti atëherë kishte deklaruar se "konstituimi kësaj radhe nuk bën të jetë drejt një shpërndarjeje të Kuvendit dhe përsëri zgjedhjeve të parakohshme, të paarsyeshme e të panevojshme". Një vazhdim i radhës i seancës konstituive është caktuar për të mërkurën më 9 shtator, nga kryesuesi Avni Dehari.

Por, a do të mbyllet konstituimi i Kuvendit brenda kësaj dite?

Marrëveshja politike për presidentin, e cila ishte parakusht për Kurtin që të vazhdohej me seancën konstituive, u arrit më 31 gusht midis LVV-së dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Megjithëse votat për Bekim Sejdiu, kandidatin për të cilin u pajtuan të dy partitë, nuk janë tashmë të sigurta, mbetet e paqartë nëse veç dakordimi për emrin e tij do të mjaftojë që deputetët ta mbyllin të mërkurën konstituimin apo do të kërkohet sërish kohë shtesë.

"Nesër e kanë thirrur seancën e Kuvendit, do të jemi aty", ishte përgjigja e Kurtit të martën kur u pyet nga gazetarët se a do të propozojnë kandidatin për kryetar të Kuvendit.

Megjithëse e konsideruan jashtë aftit kushtetues, dy partitë opozitare Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe LDK-ja kanë deklaruar se do të marrin pjesë në seancën e 9 shtatorit. Kreyetari i PDK-së, Bedri Hamza, deklaroi të hënën se Kosova duhet të ketë Kuvend të konstituuar, ndërsa tregoi se deputetja, Vlora Çitaku, do të jetë kandidate për nënkryetare të dytë të Kuvendit.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja
për sigurinë në shkollat e
Shqipërisë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:45

Detaje nga të shtënat me armë
në Mat/ Reth 30 gëzhoja
gjenden në vendngjarje,
pronarët e mjetit të djegur
sapo ishin kthye nga Italia

"Ne nuk kemi përgjegjësi pse deri tash nuk është konstituuar Kuvendi. Ne çdo 48 orë kemi qenë në Kuvend", tha Hamza.

Pjesëmarrjen e LDK-së në seancë e konfirmoi para mediave të hënën deputetja e kësaj partie Jehona Lushaku.

Vendosëm si grup që të marrim pjesë në seancën konstituive të Kuvendit të Kosovës dhe t'i kontribuojmë konstituimit të Kuvendit, meqë Kosova është në një fazë të rëndësishme për themelimin e institucioneve dhe funksionalitetin e saj, tha ajo.

Ndërkaq, Aleanca nuk ka njoftuar ende zyrtarisht se a do të marrin pjesë në seancën e së mërkurës. Mirëpo, deputeti i kësaj partie, Ramush Haradinaj, deklaroi të hënën në televizionin T7 se "na ka mbaruar mandati si deputet pas tejkalimit të afatit".

"Unë nuk kam mandat më, të shkoj në një seancë pa mandat kushtetues, nuk lejohet", tha Haradinaj.

Cili ishte afati për konstituim?

Sipas një aktgjykimi të vitit të kaluar të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve. Ky afat përfundoi më 7 gusht 2026.

Në një përplasje midis deputetëve të opozitës dhe atyre të Lëvizjes Vetëvendosje më 12 gusht kur Kuvendi priste vizitorë nga diaspora, ministërja në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, kishte argumentuar se kishin kohë 30 ditë për ta konstituuar Kuvendin nga dita kur ishte thirrur seanca konstituive më 6 gusht. "Është 6 shtator", kishte deklaruar Gërvalla sa i përket ditës së fundit të këtij afati, i cili tashmë është tejkaluar.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vlerëson se konstituimi i Kuvendit është një obligim kushtetues që nuk duhet të anashkalohej, pavarësisht shklejes së afateve kushtetuese.

"Konstatimi i kësaj shkeljeje riuk nënkupton se shkelja duhet të vazhdojë. Përkundrazi. Fakti se Kuvendi nuk është konstituuar brenda afatit kushtetues nuk mund të shërbejë si argument që Kuvendi të mos konstituohet as pas kalimit të këtij afati", thuhet në reagimin e IKD-së.

Sipas tyre përfundimi i afatit nuk mund të nënkuptojë përfundimin e detyrimit për t'i bërë institucionet funksionale.

"Shkelja që ka ndodhur duhet të konstatohet dhe të mos relativizohet, por ajo nuk mund të përdoret për të prodhuar një bllokadë të re dhe potencialisht të pakufishme".

Kuvendi konsiderohet i konstituuar me zgjedhjen e kryetarit dhe të pesë nënkryetarëve. Pas kësaj i hapet rrugë mabjtjes së seancave për zgjedhjen e qeverisë së re dhe presidentit të ri të Kosovës. Për formimin e Qeverisë së re nga LVV kanë deklaruar se nuk u mungojnë 61 votat e nevojshme, por për çështjen e presidentit votat ende nuk janë të sigurta.

Gjashtë nga 18 deputetët e LDK-së kundërshtuan marrëveshjen që partia e tyre e ariti në fundin e gushtit me LVV-në, që Bekim Sejdiu të kandidohet për president. Sipas rregullit kushtetues, në dy rundet e para presidenti zgjidhet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, pra 80 vota nga 120 deputetë.

Nëse nuk arihet kjo shumicë, kalohet në rundin e tretë, ku presidenti zgjidhet me një shumicë të thjeshtë prej 61 votash, por nevojitet prania e të paktën 80 deputetëve në sallë që ky votim të jetë i vlefshëm. Partia fituese e zgjedhjeve, LVV-ja, ka 53 deputetë, dhe llogarit edhe në votën e 10 deputetëve nga komunitetet pakicë.

Kurse, partia e tretë, LDK-ja, ka 18 deputetë, gjashtë prej të cilëve janë deklaruar kundër kandidaturës së Sejdiut. Kjo nënkupton se marrëveshja për presidentin tani për tani gëzon mbështetjen e 74 deputetëve. Ndërkaq, PDK-ja e cila ka 22 deputetë, nuk ka ofruar mbështetje për këtë kandidat, ashtu sikurse Aleanca, e cila ka kushtëzuar votën të deputetëve të saj. Mirëpo kreu i LVV-së tha më 8 shtator se do të vazhdojnë edhe më tutje takimet dhe bisedimet për ta zgjedhur presidentin e ri të vendit, për të parandaluar shkurorën në zgjedhje./REL

DOI:10.1002/for

Kremlini sjell në front reliktet
e një princi të shekullit të 14-të

më të klikuarat

**"Qepeni gojën" / Debate për
shkrirjen e bashkisë, Rama
përplasët me banorët e
Poliçanit dhe
kryebashkiakun socialist
Adriatik Zotkaj! Qytetarët
largohen nga takimi**

**Nga "Taken" te Thethi/
TikTokeri, me 4 milionë
ndjekës, që i tregoi botës një
Shqipëri tjetër**

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

**REPUBLIKA E
TRUPROJAVE/ Nga
tokat te klubet VIP:
Rrjoll, Zvërnec,
Sarandë e Ksamil
nën hijen e "burrave
të zinj"**

Moti

Powered by  tomorrow.

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:02

Vatër zjarri në Rras të Lezhës, flakët përhapen drejt banesave

Pamje nga zjarri LEZHË- Një vatër zjarri është regjistruar në fshatin Rras, në Njësinë Administrative Ugr...

U arrestua nga policia gjatë protestës/
Protestuesi: Kisha blerë vezë...

Aktualitet

8 Shtator 2026, 18:02

VIDEO/ Po mbante vezë në duar, policia
shtrin përtokë protestuesin dhe e
shoqëron në komisariat

Aktualitet

8 Shtator 2026, 17:53

VIDEO/ Tensione tek Ushtari i Panjohur,
protestuesit gjuajnë me vezë: Nuk na
përfaqësoni

Aktualitet

8 Shtator 2026, 17:42

Protesta para Kuvendit/ Qytetarët i bëjnë
thirrje SPAK: Arrestoni Ramën!

Aktualitet

8 Shtator 2026, 17:28

Aktualitet

8 Shtator 2026, 17:20

Vatër zjarri në Drapata të Librazhdit, rrezikohet një banesë, ndërhyjnë zjarrfikëset

Pamje nga zjarri LIBRAZHD- Një vatër zjarri është regjistruar ditën e sotme në lagjen Drapata, në Njësinë...

VIDEO/ Tensione jashtë Parlamentit, Policia shoqëron 2 protestues, momenti kur 'Shqiponjat' i mbërthejnë

Aktualitet

8 Shtator 2026, 17:14

"Ti nuk i përfaqëson gratë" / Protestuesit i vihen prapa Iris Luarasit: Hajdute, nuk je mbrojtësja e grave (VIDEO)

Aktualitet

8 Shtator 2026, 16:59

Shpërndanin lëndë narkotike/ Gjikata e Sarandës lë në burg 20 persona, mes tyre dhe te huaj

Aktualitet

8 Shtator 2026, 16:29

Sheshi "Nënë Tereza" do transformohet totalisht. Shikoni projektin (FOTO)

Aktualitet


8 Shtator 2026, 16:10

MË SHUMË

dosja

Trenë

Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U soll si sulltan, u tha qepeni



Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U

Shiko video te tjera

gojen

Dita e 106-të e protestës/ Nis marshimi drejt Kryeministritë: Shqipëria kërkon revolucion

Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca?, ndryshon vetëm drejtimi vendor

Digjet një banesë në lagjen Kastriot të Fushë-Krujës, shkak një luhatje e energjisë elektrike

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.